



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-13328/25, më 27 JAN 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet caktimi i organit mbikëqyrës për kontratat e lidhura ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Operatorëve Privat të Transportit Publik për territorin e Komunës së Prishtinës.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, anëtarë të organit mbikëqyrës janë:
 1. Habib Qorri, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Menaxher i kontratës;
 2. Enver Kadriu, Drejtoria e Shërbimeve Publike, mbikëqyrës i kontratës;
 3. Argjende Hyseni, Drejtoria e Shërbimeve Publike, mbikëqyrës i kontratës;
 4. Blerta Ibishi, Drejtoria e Shërbimeve Publike, mbikëqyrës i kontratës;
 5. Lejla Gashi, Drejtoria e Shërbimeve Publike, mbikëqyrës i kontratës;
 6. Vjosa Kollani, Drejtoria e Shërbimeve Publike, mbikëqyrës i kontratës;
3. Detyrat dhe punët e organit mbikëqyrës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi janë: Mbikëqyrja dhe menaxhimi i kontratës, konstatimi i kompensimit për km që i paguhet operatorit për ofrimin e shërbimeve të autobusëve dhe ndërmarrja e veprimeve sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.
4. Për kryerjen e punëve si në pikën 3 të këtij Vendimi, organi mbikëqyrës do t'i raportoj Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të organit mbikëqyrës;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

